

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë
Факултет за бизнис и економија
Faculty of Business and Economics

STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA:

**Ndikimi i Rrjeteve Sociale Online në Vendimarrjen e
Konsumatorit Gjatë Procesit të Blerjes në Industrinë e Tekstilit**

Kandidati/ja:

Drita Jonuzi

Mentori

Prof. Dr. Jusuf Zekiri

Tetovë, 2019

FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE

Do të doja të falemnderoj të gjithë ata që morën pjesë dhe dhanë kontributin e tyre në kompletimin e këtijë raporti hulumtues.

Fillimisht, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të singertë për mentorin tim Prof. Dr. Jusuf Zekirin, për mbështetjen e vazhdueshme të studimeve dhe hulumtimeve, për durimin, motivimin, entuziazmin dhe njohurin e jashtëzakonshme. Udhëzimi i tij më ndihmoi gjatë gjithë kohës së hulumtimit dhe shkrimit të kësaj teze. Përveç mentorit tim, do të doja të falënderoj pjesën tjetër të komisionit tim të tezës: Prof. Dr. Teuta Veseli dhe Prof. Dr. Nasir Selimi për inkurajimin e tyre, komentet intuitive dhe pyetjet e vështira.

Gjithashtu, falemnderoj të gjithë miqtë dhe të afërmit e mi te cilët me ofruan ndihmë me sugjerimet e tyre duke me motivuar ende më shumë në realizimin cilësor të këtijë projekti. Së fundi, dëshiroj të falënderoj familjen time për përkrahjen e tyre morale dhe profesionale e cila nuk mungoi asnjëherë.

Abstrakt

Mediat sociale ose më saktë, përmbajtja që është e lehtë për t'u shpërndarë nëpërmjet mediave sociale dhe atë në një sferë shumë të gjerë, ka aftësinë për të ndikuar në sjellen konsumatore në mënyra shumë të ndryshme specifike që janë mjaft të rëndësishme për pronarët e bizneseve. Pronarët janë të etur për të kapur këtë zhvillim, andaj ata tentojnë për të arritur këto mundësi të arta duke i ranguar konsumatorët e tyre në “qendër” në botën e biznesit për shkak të mediave sociale. Në etapat e mëhershme, reklamimi më të vërtetë kishte ndikim mjaft të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes së konsumatorit. Por ishte fjala e gojës (word of mouth) që kishte një ndikim ende më të madh gjatë vendimmarrjes konsumatore në procesin e blerjes, por rrjetet para-sociale si fjala e gojës thjesht nuk udhëtonte shumë larg. Ndërsa, në ditët e sotme janë mediat sociale ato që i japin krahët e gojës. Ndikimi i mediave sociale duke përfshire vetëdijen e klienteles, preferencat e tyre, qëndrimet e markave si dhe normat shoqërore është aq e fortë që shpesh i referohemi marketingut viral për të stimuluar fjalën pozitive të gojës.

Qëllimi i këtijë projekti hulumtues është të shpjegojë pse, kur dhe si media sociale ndikojnë në vendimmarrjen konsumatore gjatë procesit të blerjes në industrinë e tekstilit. Përmbajtja teorike mbështetet në literature, si dhe në studimet e mëparshme të ngjajshme në lidhje me marketingun e mediave sociale. Aplikimi i hulumtimit sasior është përshtatur për qëllimet e këtij projekti.

Ky hulumtim jep shpjegime se si individët marrin, përpunojnë dhe zgjedhin informacionin mbi mediat sociale përpara se ata të bëjnë një blerje. Përfundimet dhe rekomandimet e paraqitura në këtë projekt janë të vlefshme vetëm brenda përzgjedhjes së popullsisë (mostrës) dhe nuk mund të përgjithësohen diku tjetër për arsye të diferencimeve në faktorët mjedisorë.

Fjalët kyqe: Vendimmarrja e konsumatorit, Mediat sociale, Informim i shpejtë, Marketingu online, Fazat e vendimit të blerjes.

Abstract

Social media or more precisely, the content that is easy to be distributed through social media and that in a very broad sphere has the ability to influence consumer decision-making process in many different specific ways that are very important to the owners of businesses. Owners are eager to capture this development, and they try to seize these gold opportunities by appreciating their consumers in the “center” of their businesses because of social media. In the past, advertising had a very significant impact on the consumer decision-making process. However, “word of mouth” had an even greater impact on consumer decision-making, but pre-social networks like word of mouth did not travel in a very broad scope. Nowadays, social media is the main key of giving power to word of mouth. The impact of social media, including customer awareness, their preferences, brand attitudes, and social norms is so strong that we often refer to viral marketing to stimulate the positive word of mouth.

The purpose of this research is to explain why, when and how social media influence consumer decision-making during the buying process in the textile industry. The theoretical summary is built on literature, as well as on previous similar studies related to social media marketing. The quantitative research is applied for the purposes of this project.

This research provides explanations on how individuals participate, process and choose social media information before a purchase. The conclusions and recommendations presented in this project are valid only within the sample selection (sample) and cannot be generalized elsewhere because of differences in environmental phenomena.

Key words: Consumer decision-making process, Social media, Fast information, Online marketing, Purchase decision stages.

Përmbajtja

1.1	Lënda e hulumtimit	8
1.2	Qëllimi i hulumtimit	8
1.3	Problematika e ngritur	9
1.4	Hipotezat e ngritura	10
1.5	Metodologjia e hulumtimit	10
1.6	Struktura e punimit	12
2.1	Zgjerimi i rrjeteve sociale	15
2.1.1	Statistikat e mediave sociale në mbështetjen e marketingut (2019).....	16
2.2	Media sociale si mjet i ri marketingu.....	18
2.3	Roli i mediave sociale në zhvillimin e markave të tekstilit	19
2.3.1	Statistikat e mediave sociale që ndikojnë në industrinë e tekstilit	20
2.3.2	Pse konsumatorët përdorin Mediat Sociale për të blerë?	22
2.3.3	Lloji i mediave sociale të përdorura kryesisht nga konsumatorët	23
2.4	Modeli klasik/tradicional i blerjes	23
2.5	Ndikimi i rrjeteve sociale në internet në vendimin e blerjes së konsumatorëve	24
2.5.1	Komunikimi me “fjala e gojës”	25
2.5.1.1	Forma elektronike	26
3.1	Qëllimi hulumtimit	29
3.1.1	Plani kërkimor	29
3.1.1.1	Formulimi i pyetësorit.....	30
3.1.1.2	Mostra	33
3.1.1.3	Forma e komunikimit	33
3.1.2	Mbledhja e të dhënave	34
3.1.2.1	Metodat dytësore të grumbullimit të të dhënave	34
3.1.2.2	Metodat primare të grumbullimit të të dhënave	35
3.1.3	Vlefshmëria dhe Besueshmëria e anketimit	35
3.1.3.1	Metodat efektive për të rritur pjesëmarrjen në anketim.....	36
3.1.4	Rrethanat Limituese	38
4.1	Analiza dhe komentimi i rezultateve	40

5.1 Përfundimet	57
5.1.1 Përfundimet teorike	57
5.1.2 Përfundimet praktike	58
5.2 Rekomandimet	60
Bibliography	63
Shtojcat	66
Appendix#1 Pytesori.....	66

KAPITULLI 1

HYRJE

1.1 Lënda e hulumtimit

1.2 Qëllimi i hulumtimit

1.3 Problematika e ngritur

1.4 Hipotezat e ngritura

1.5 Metodologjia e hulumtimit

1.6 Struktura e punimit

1.1 Lënda e hulumtimit

Ky projekt hulumtues paraqet ndikimin rrjeteve sociale në vendimarrjen e konsumatorit gjatë procesit të blerjes, përkatsisht në industrinë e tekstit.

Teknologjia dhe burimi i internetit kanë përkrahur njerëzit të komunikojnë me njëri-tjetrin, të ndajnë informacione si dhe të ndërtojnë marrëdhënie. “Rrjeti social” është një formë e re komunikuese e cila aplikohet përmes mediave sociale dhe lejojnë njerëzit të bashkëveprojnë dhe të bisedojnë me njëri-tjetrin. Me aplikimin e mediave sociale si dhe prezencën e marketingut në internet, pronarët e bizneseve më shumë lehtësi ndikojnë në forma të ndryshme të konsumatorëve në vendimarrjen e tyre gjatë procesit të blerjes. Tani konsumatorët përmes mediave sociale vlerësojnë produktin, lidhin blerjet e tanishme me blerjet e ardhshme si dhe bëjnë rekomandime për familjarët dhe miqtë e tyre. Edhe për firmat, përdorimi i medias sociale është një mjet mjaft i frytshëm sepse një konsumator i kënaqur i një produkti apo shërbimi mund të rekomandojë atë të mirë ose shërbim tek përdoruesit e tjerë të mundshëm. Për këto arsye, avancimi i mediave sociale në ditët e sotme luan një ndër rolet kyçe tek bizneset duke iu lejuar atyre për të rritur popullaritetin e tyre, për të rritur ndërgjegjësimin e markës në mesin e klientëve në internet, për të rritur shitjet, për të lehtësuar komunikimin e fjalëve të gojës dhe për të siguruar mbështetje sociale për klientët në internet.

Për më tepër, mediat sociale kanë ndikuar në zhvillimin e strategjive të reja të marketingut të cilat qëllimin primar e kanë ndërtimin e besimit tek klientëve për të blerë brenda platformave sociale më të besueshme.

1.2 Qëllimi i hulumtimit

Fokusimi në zhvillimin global si dhe përdorimi i teknologjisë në fushën e marketingut, reklamimit dhe promovimit kanë fokusuar kompanitë ende më shumë tek konsumatorët. Në

etapën e me hershme, ishte mjaft popullore për industrin e tekstit që të na paraqitej përmes revistave të shkëlqyera dhe shfaqjeve të ndryshme. Nëpërmjet këtyre kanaleve të kontrolluara, moda u mbajt ekskluzive, e përcaktuar nga hartuesit dhe redaktorët e revistës. Por kjo nuk është e mjaftueshme tani. Teknologjia është bërë një element shumë i rëndësishëm në zgjerimin e tregjeve duke përcaktuar strategji të tëra të marketingut. Në të njëjtën kohë, reklamimi dhe promovimi përqendrohen në faktorët kyq të konsumatorit (psikologjik, emocional dhe social) që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit; elemente këto që duhet të përfshihen në marketing të bazuar në teknologji. Si rezultat i kësaj, kompanitë duhet të kene kujdes ende me të madh gjatë analizës dhe implementimit të 4p (produkti, çmimi, vendi dhe promovimi). Andaj, qëllimi i këtij projekti hulumtues është;

1. Identifikimi i ndikimit të rrjeteve sociale në vendimarrjen e konsumatorit gjatë procesit të blerjes
2. Për të vendosur se sa shpesh konsumatorët hasin në mesazhe të marketingut në rrjetet e ndryshme sociale
3. Të përcaktohet shkalla në të cilën marketingu social ndikon në qëndrimet e konsumatorëve

1.3 Problematika e ngritur

Mediat sociale kanë ofruar mundësi të reja për konsumatorët që të angazhohen në bashkëveprimin social në internet. Konsumatorët përdorin lloje të ndryshme të mediat sociale, për të nxjerre informacion dhe për ta shpërndarë atë me përdorues të tjerë. Komunitetet virtuale, blogs dhe faqet e rrjeteve sociale në internet ofrojnë një platformë për të ndikuar vendimet e blerjes së konsumatorëve. Konsumatorët blejnë gjëra që janë relevante për nevojat e tyre. Në të njëjtën kohë ata bëjnë vendime blerjeje. Bashkë-kontakti social më njëri-tjertin në një mënyre prek vendimet e përditshme të blerjes së konsumatorit. Shtresa të ndryshme siç janë anëtarët e familjes, miqtë dhe kolegët kanë ndikim tek konsumatorët. Këto sfera njerëzish mund të përfshihen në rrjetet shoqërore të konsumatorëve, dhe të ndikojnë tek ata edhe përmes internetit. Konsumatorët marrin vendime shumë produktive çdo ditë dhe dëshirojnë të

marrin këshilla nga të tjerët. Kështu ata përdorin rrjetet sociale si një platformë të mirë për të mbledhur informacione dhe këshilla. Duke marrë parasysh këtë rrjedhe, në këtë punim rëndësi fillestare do ti jepet peshës së madhe të rrjeteve sociale tek përzgjedhja e produktit nga konsumatorët.

1.4 Hipotezat e ngritura

Projekti hulumtues do t'ju jap përgjigje këtyre pyetjeve kërkimore;

Pyetja kërkimore 1: Si ndikojn lloje të ndryshme të mediave sociale në marrjen e vendimit gjatë procesit të blerjes?

Pyetja kërkimore 2: Deri në çfarë mase marketingu social ndikon në qëndrimet e konsumatorëve?

Pyetja kërkimore 3: Sa ndikon fjala e gojës (word of mouth si burim informacioni)?

Pyetja kërkimore 4: Deri në çfarë mase ndikon marketingu social në konsumin e konsumatorëve?

Ndërkaq si hipoteza që ky punim do të t'i testoj do të jenë:

H1: Lloje të ndryshme të mediave sociale ndikojnë vrullshëm në marrjen e vendimit të konsumatorit gjatë procesit të blerjes

H2: Konsumatorët mbështeten në rrjetet sociale për të udhëhequr vendimet e blerjes

H3: Fjala e gojës (word of mouth) është burim kryesor informacioni gjatë marrjes së vendimit të konsumatorit në procesin e blerjes

1.5 Metodologjia e hulumtimit

Seksioni i metodologjisë së hulumtimit përshkruan të gjitha veprimet e nevojshme që duhen të ndërmerren për të hetuar një problem kërkimi. Specifikisht paraqet zbatimin e teknikave që përdoren për të identifikuar, zgjedhur, përpunuar dhe analizuar informacionet e aplikuara, duke lejuar lexuesin të vlerësojë në mënyrë kritike korrektsinë e përgjithshme të hulumtimit dhe besueshmërinë. Kjo pjesë e projektit iu përgjigjet dy pyetjeve kryesore: Si u grumbulluan apo

gjeneruan të dhënat? Dhe, si u analizuan ato? Për këtë arsye, ky punim do të ndërtohet sipas metodës së mbledhjes së të dhënave – grumbullimi i të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat sekondare janë të dhënat që tashme e një kohe egzistojnë dhe janë të publikuara në revista, portale, libra, gazeta apo internet, etj. Tek këto të dhëna ekziston një sasi e madhe e informacioneve në lidhje me fushën e kërkimit pa marrë parasysh natyrën e zonës kërkimore. Prandaj, aplikimi i të dhënave sekondare që do të përdoren në studim luan një rol të rëndësishëm në drejtim të rritjes së niveleve të vlefshmërisë dhe besueshmërisë së hulumtimit.

Këto kritere përfshijnë:

- Datën e publikimit
- Besueshmërinë e autorit
- Besueshmërinë e burimit
- Cilësinë e diskutimeve
- Thellësinë e analizave
- Shkallën e kontributit të tekstit në zhvillimin e zonës së hulumtimit, etj (Data Collection Methods - Research-Methodology).

Në këtë projekt është bërë një shqyrtim mjaft i detajuar i literaturës e cila përmbush të gjitha kriteret e sapo përmendura më sipër. Përmbajtja e literaturës në këtë punim përfshinë temat vijuese si: zgjerimi i rrjeteve sociale, media sociale si mjet i ri në marketing, roli i mediave sociale në zhvillimin e markave të tekstit, cili lloj i konsumatorëve ndikohen më së shumti nga rrjetet sociale dhe pse konsumatorët përdorin mediat sociale për të blerë. Gjithashtu në këtë përmbajtje përfshihen dhe temat tjera vijuese si: lloji i mediave sociale të përdorura kryesisht nga konsumatorët, modeli klasik/traditional i blerjes, ndikimi i rrjeteve sociale në internet në vendimin e blerjes së konsumatorëve, komunikimi me “fjala e gojës”, etj.

Metodat e mbledhjes së të dhënave primare ndahen në dy grupe:

1. Sasiore dhe
2. Cilësore

- 1. Metodatat e mbledhjes sasore** - bazohet në forma të ndryshme të llogaritjeve matematikore. Një prej formave më të shpeshta të përdorura është aplikimi i pyëtësorit siq edhe është bërë në këtë projekt. Në krahasim me metodatat cilësore, kjo metodë është më e lehtë t'u zbatuar dhe mund të aplikohet brenda kohëzgjatjes me të shkurtër. Gjithashtu është e lehtë të bëhen edhe krahasime të gjetjeve.
- 2. Metodatat kërkimore cilësore** - nuk përfshijnë numra apo llogaritjet matematikore. Kjo metodë është e lidhur ngushtë me fjalët, tingujt, ndjenjat/emocionet dhe elementët e tjerë që nuk janë të përcaktueshëm. Për më shumë, metoda cilësore siguron një nivel mjaft të lartë të të kuptuarit.

Edhe në këtë punim hulumtues janë aplikuar të dy llojet e të dhënave, siq është cekur edhe në seksionet e më hershme të projektit.

Të dhënat sekondare do të mbledhen nga studimet, anketimet ose eksperimentet që janë drejtuar nga njerëz të tjerë ose për hulumtime të tjera por të se njëjtes fushe studimi. Ndërsa të dhënat primare do të grumbullohen dhe aplikohen pas kompletimit dhe finalizimit të të dhënave sekondare. Si bazë për përgaditjen e këtij punimi do të shërbejnë anketat e realizuara tek konsumatorët të cilat do të sigurojnë të dhënat e nevojshme.

Aplikimi i kësaj strukture metodologjike do të shërbejë për zbatim më të mirë të projektit, duke e organizuar dhe kompletuar punimin në një rrjedhë mjaft të kuptueshme dhe të avancuar njëkohësisht.

1.6 Struktura e punimit

Punimi është i ndarë në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë paraqitet hyrja e cila përfshinë parathënien, lënden e hulumtimit, rëndësine e hulumtimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e parashtruara, metodologjinë si dhe qëllimet e studimit. Në kapitullin e dytë parashtrohet rishikimi i literaturës e cila përmban temat vijuese si: rrjetet sociale në internet, sjellja e vendimmarrjes së blerësve, ndikimi i rrjeteve sociale në internet në vendimin e blerjes së konsumatorëve, komunikimi me “fjala e gojës”, ndërveprimi i konsumatorëve në rrjetet

shoqërore në internet, etj. Në kapitullin e tretë përfshihet metodologjia e cila ndërthure në vetvete pjesët me kryesore si: qëllimi i hulumtimit, llojet e hulumtimit, procesi i hulumtimit, mostra e hulumtimit, instrumenti i hulumtimit dhe limitimet e hulumtimit. Kapitulli i katërt përmban prezantimin dhe analizimin e të dhënave të cilat janë të paraqitura në forma të ndryshme grafike dhe shkruese. Ndërsa kapitulli i pestë paraqet përfundimet e nxjerra nga rezultatet finale të fituara në projekt se bashku me rekomandimet shtesë. Dhe kapitulli i gjashtë dhe njëkohsishtë i fundit përmban pjesën e referencave.

KAPITULLI 2

LITERATURA

2.1 Zgjerimi i rrjeteve sociale

2.1.1 Statistikat e mediave sociale në mbështetjen e marketingut (2019)

2.2 Media sociale si mjet i ri marketingu

2.3 Roli i mediave sociale në zhvillimin e markave të tekstilit

2.3.1 Cili lloj i konsumatorëve ndikohen më së shumti nga rrjetet sociale?

2.3.2 Pse konsumatorët përdorin Mediat Sociale për të blerë?

2.3.3 Lloji i mediave sociale të përdorura kryesisht nga konsumatorët

2.4 Modeli klasik/traditional i blerjes

2.5 Ndikimi i rrjeteve sociale në internet në vendimin e blerjes së konsumatorëve

2.5.1 Komunikimi me “fjala e gojës”

2.5.1.1 Forma elektronike

2.1 Zgjerimi i rrjeteve sociale

Avancimi në teknologji po rritet qdo ditë e më shumë dhe biznesi digjital tashme po ushtron një rol mjaft të rëndësishëm në vendet me të zhvilluara globale. Në etapën e fundit, zhvillimi aq i hovshëm teknologjik iu lejonë njëzë të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në një mjedis virtual. Sipas O'Reilly (2009), rrjetet sociale po cilësohen si një “etikete” e re për teknologjinë dhe lehtëson ende me shumë sjelljen e klienteles në ndërveprimin e përdoruesve në internet. Me ekzistencën e platformave të ndryshme në internet, njerëzit janë gjithnjë e më shumë të lidhur, pavarësisht shtrirjes gjeografike e cila dikur e një kohe ka ndarë individë (Clodagh, 2019). Sipas Merriam, “mediat sociale mund të përkufizohen si faqet e internetit ose aplikacionet, të cilat u mundësojnë përdoruesve të marrin pjesë në rrjetet sociale duke krijuar ose shpërndarë përmbajtje” (Webster, par.3). Duke u bazuar në këtë përkufizim, atëherë lehtë mund të kuptohet se mediat sociale përfshijnë faqen e rrjeteve të tilla si Facebook, Twitter, Instagram dhe Youtube. Jo me kaq, në media sociale rangohen edhe faqet e blogging, email, dhoma chat dhe forume. Mediat sociale dikur shërbenin me qëllimin kryesorë për të kontaktuar me njerëz, miqet apo familjaret. Në vitet e fundit, mediat sociale u bënë një vend ku njerëzit, qeveria dhe organizatat ndërveprojnë me njëri-tjetrin.


Industria e cila konsiderohet që të jetë me e prekshme nga mediat sociale është natyrisht industria e tekstilit. Kur flasim për mediat sociale për industrinë e tekstilit, ajo i referohet aplikacioneve dhe platformave të ndryshme në internet që i mundësojnë industrisë të lidhen me konsumatorët e tyre duke përdorur teknologjinë më të fundit të rrjeteve sociale. Industria e tekstilit është e kyqur në përdorimin e mediave sociale me qëllim studimin e tendencave dhe për të parashikuar sjelljet e modës.

2.1.1 Statistikat e mediave sociale në mbështetjen e marketingut (2019)

Mediat sociale janë bërë një ndër elementet më të rëndësishme të strategjive të komunikimit digjital. Specifikisht, mediat sociale ofrojnë rezultate mjaft të mira dhe të matshme si në shitjet, drejtimet dhe etiketimin. Duke përfshirë këtë shtrirje kaq të gjerë, mediat sociale iu lejojnë bizneseve të arrijnë një audiencë të madhe me një kosto të ulët (HAINLA, 2019).

Sipas “Social Media Marketing Statistics of 2019”, ekzistojnë 3.48 miliardë përdorues të mediave sociale në 2019, me një rritje në mbarë botën me 288 milionë (9 për qind) në krahasim me vitin e kaluar, 2018.

Figura 1. Statistikat e mediave sociale në përgjithësi



Burimi: <https://www.dreamgrow.com/21-social-media-marketing-statistics/>

Në bazë të këtyre statistikave të paraqitura në figurën 1, janë nxjerrur rezultatet e mëposhtme:

- Individet e grup-moshës 18-34 vjeç kanë më shumë gjasa të ndjekin një markë nëpërmjet rrjeteve sociale

- Rreth 71% e konsumatorëve që kanë pasur eksperiencë të mirë me shërbimin nga mediat sociale bëjnë rekomandime tek të tjerët
- 63% e konsumatorëve presin që kompanitë të ofrojnë shërbimin nëpërmjet kanaleve të tyre në media sociale dhe 90% e përdoruesve të mediave sociale kanë përdorur tashmë mediat sociale si një mënyrë për të komunikuar me një markë ose biznes

Statistikat e Facebook

Facebook në vitin 2015 ndikoi në 52 për qind të blerjeve online dhe offline të konsumatorëve, që ishte një rritje e 36% nga ajo e regjistruar në vitin 2014. Kjo nënkupton se tashme shitësit menaxhojnë kanalet e mediave të tyre sociale më qëllim që të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në sjelljen e blerjes.

Egzistojnë rreth 50 milionë biznese të vogla që për t'u lidhur me klientët e tyre përdorin Faqet e Facebook-ut. Afër 4 milion prej këtyre bizneseve të vogla paguajnë për reklamat e mediave sociale në Facebook. Ata paguajnë për reklamat më qëllim që të fitojnë shikueshmëri ende më të madhe si dhe të tejkalojnë konkurrentët e tyre (Social Media Marketing Statistics, 2019).

Statistikat e Twitter

Klikimi i linjeve në twitter përbënë 92% të të gjithë ndërveprimet të përdoruesit. Ekzistojnë rreth 1.3 miliardë llogarish, por vetëm 336 milionë janë aktive. Në bazë të këtyre të dhënave mund të vërehet që rritja e Twitter është ngadalësuar (Social Media Marketing Statistics, 2019).

Statistikat e Instagram-it

Markat më të mira të prezantuar në Instagram kanë regjistruar rreth 4.21% ndjekës, vlere kjo e cila është 120 herë më e lartë se në Twitter dhe 58 herë më e lartë se në Facebook. Në krahasim me rrjetet tjera sociale, Instagram-i për momentin po shquhet që të jetë platforma me e fuqishme për tregtarët. Markat e mediave janë më aktive, gjithashtu, rritja e aktivitetit të biznesit në Instagram, frekuenca e postimit të markës po bëhet gjithnjë e më normalizuar dhe standardizuar për të nxjerrë në pah rritjen në një qasje më të matshme. Rreth 90% e

përdoruesve të Instagram janë më të rinj se 35 vjeç kurse 32% e adoleshentëve e konsiderojnë Instagramin rrjetin më të rëndësishëm social (Social Media Marketing Statistics, 2019).

2.2 Media sociale si mjet i ri marketingu

Gjatë dekadës së fundit, vendet në zhvillim gjatë gjithë kohës po përballen me një rritje të shpejtë të digjitalizimit. Me krijimin e platformave të mediave sociale, njerëzit me shumë lehtësi dhe shpejtësi kyqen në bashkëveprim me të tjerët. Andaj kompanitë tentojnë që të përfitojnë nga kjo lidhje me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të markës dhe produkteve.

Bizneset aplikojnë marketingun me qëllim për të tërhequr klientët, për t'i kënaqur dhe për t'i mbajtur ata besnikë ndaj një marke. Vetë koncepti i marketingut lidhet ngushtë me menagjimin dhe studimin e marrëdhënieve midis një marke, perspektivave të saj dhe klientëve të saj aktual. Për shkak se marketingu është multifunksional, shumë shpesh ndodh që të definohet edhe si proces edhe si koncept.

Para së gjithash, marketingu si term origjinalë i referohet tregjeve me qëllim të shitjes së mallrave dhe rritjes së shitjes njëkohesishtë. Duke u bazuar në këtë definim, Shoqata Amerikane e Marketingut (2013) e përcakton marketingun si “aktivitet, grup i institucioneve dhe proceseve për krijimin, komunikimin, shpërndarjen dhe shkëmbimin e ofertave që kanë vlerë për klientët, partnerët dhe shoqërinë në përgjithësi”. Nga ana tjetër, Kotler në vitin 2006 e definon marketingun si një proces dhe e quan atë si një proces shkëmbimi ku qëllimi primar i tij është plotësimi i nevojave dhe dëshirave të konsumatorëve. Teoricienët si Kotler dhe Keller theksojnë se marketingu është një proces mjaft i gjatë pasi që përfshinë të gjithë hapat e ranguar si më poshtë:

1. Hulumtimin e tregut ➡ 2. Targetimin dhe segmentimin ➡ 3. Përpunimin e strategjive në lidhje me çmimet ➡ 4. Promovimin dhe shpërndarjen ➡ 5. Zhvillimin e komunikimit dhe zhvillimin e qëllimeve afatgjata.

Arsyeja kryesore përse kompanitë, sidomos ato në industrinë e tekstit e aplikojnë më së shumti strategjinë e marketingut të mediave sociale është se iu sjell shumë përfitime sepse përmes kësaj strategjie kompanitë arrijnë të mbledhin përvojat e klientëve (Abrar, 2016). Gjithashtu është shumë më e lehtë të identifikohen influencersit dhe grupet e ndryshme të konsumatorëve. Përfitimi më i madh është se shpenzimet e marketingut të mediave sociale me të vërtetë janë shumë të ulëta apo thënë ndryshe minimale. Kjo është edhe mënyra më pak e shtrenjta e të bërit marketing sepse shumica e kanaleve janë pa pagesë.

2.3 Roli i mediave sociale në zhvillimin e markave të tekstit

Më qëllim për të tërhequr ende me shumë klientë në industrinë e tekstit, kompanitë janë duke aplikuar strategji të ndryshme efektive të marketingut. Me ndihmën e pranisë së rrjeteve sociale, kompanitë e tekstit aplikojnë promovimin e markave të ndryshme në kanale të mediave sociale më qëllim për të rritur ndërgjegjësimin e markës një njerën anë, dhe për të tërhequr më shumë klientë drejt biznesit në anën tjetër. Pra cili është roli i mediave sociale në zhvillimin e markave të tekstit e paraqesim me poshtë:

➤ Themelimi i identitetit

Krijimi i identitetit të një kompanie është më të vërtetë një pjesë mjaft e vështirë e cila kërkon kohë dhe përkushtim tejet të madh. Por qdo gjë bëhet më e lehtë me ekzistencën e mediave sociale të cilat kanë aftësinë për t'i dhënë kompanisë një identitet që do të njihet nga një vend i veçantë.

➤ Ndërveprimi me blerësit

Mediat sociale i kanë ndihmuar kompanitë që të jenë të afrueshme me klientet e tyre si kurrë më parë.

➤ Mbajtja e profesionalizmit

Shpesh vie në shprehje se kompanitë të cilat bashkëveprojnë me klientet e tyre përmes rrjeteve sociale nuk tregohen që të jenë profesionale në aktivitetet e tyre. Por përkundrazi, sa më shumë që kompanitë kontaktojnë me klientelën e vet dhe janë më të afrueshëm, atëherë formohet një kombinim mjaft i mirë i profesionalizmit.

➤ **Rritja e audiencës**

Një ndër synimet kryesore të qdo kompanie është zgjerimi i audiencës. Me strategjinë e duhur, është e mundur arritja e një audience më të madhe. Me ndihmën e postimeve të ndryshme, kompanite targetojnë konsumatorët e tyre duke marrë parasysh edhe faktorin demografik.

➤ **Ndërtimi i reputacionit**

Ndërtimi i reputacionit gjithashtu ka rëndësi mjaft të madhe për qdo kompani në industrinë e tekstilit. Me përdorimin e mediave sociale, kompanitë kanë me pak shpenzime për reklamat si dhe shpenzimet e tjera që janë të njohura për t'i shqetësuar ato markat e filluara me buxhet të kufizuar. Me qasjen e duhur në mediat sociale, është e mundur krijimi i një pozite të lidershipit në treg.

2.3.1 Statistikat e mediave sociale që ndikojnë në industrinë e tekstilit

Mediat sociale gjatë gjithë kohës janë në ndryshim si rezultat i mënyres se kërkimit nga përdoruesit, komunikimit me miqët dhe familjen, etj. Sa më shumë që vazhdon avancimi i rrjeteve sociale, aq më e ndikuar bëhet jeta jonë nga ato. Studimet e fundit kanë mbledhur statistika që tregojnë se individët përdorin mediat sociale si frymëzim në industrinë e tekstilit të cilat njëkohësisht ndikojnë edhe në vendimin e blerjes (Storms, 2017). Më poshtë është përpiluar një listë me 10 statistika të dobishme lidhur me mënyrën se si mediat sociale ndikojnë në industrinë e tekstilit:

1. 64% e blerësve social përdorin mediat sociale si frymëzim para se të bëjnë një vendim blerjeje. Ata më se shumti përdorin bordet e mesazheve dhe bloget për të zbuluar markat e modës
2. 27% e konsumatorëve ndikohen nga Pinterest. Sa për qartësi, Pinterest është rrjeti social i mediave që lejon përdoruesit të ndajnë imazhe të lidhura me projektin, mallrat dhe shërbimet dhe të zbulojnë vizualisht interesa të reja duke shfletuar imazhe të tjerëve që kanë postuar. Pinterest është më të vërtetë një mënyrë e shkëlqyeshme për të bërë blerje online lehtë dhe të përshtatshme për blerësit

3. Gjysma e blerësve të Pinterest kanë krijuar një tabelë specifike për një vendim blerjeje. Jo vetëm që bordet lejojnë përdoruesit e Pinterest të krijojnë dhe ndajnë pamjet e tyre, por gjithashtu mund të ndihmojnë në parashikimin e sjelljes së blerjes
4. Rreth 42% të grave të moshës 18-29 vjeç frymëzohen nga Instagram në aspektin e modës frymëzuese
5. Konsumatorët kanë dy herë më shumë gjasa të shikojnë video online për të bërë kërkimet e tyre të modës. Ikonat e modës shpesh shfaqin pamjet dhe produktet e tyre të preferuara në kanalet e tyre në YouTube. Bukuria dhe mësimet e modës janë një mënyrë e mençur për të arritur një objektiv të ri me fuqi të fuqishme blerëse
6. 72% e blerësve social janë të ndikuar nga Facebook në të paktën një kategori modës
7. Facebook llogaritet për 22% të blerjeve të drejtpërdrejta sociale në shitje në modë dhe bukuri.
8. 56% e blerësve të veshjeve përdorin pajisjet e tyre mobile për të krahasuar çmimet online, 44% për të kërkuar marrëveshje dhe promovime, dhe 42% për të lexuar rishikime online
9. Konsumatorët përmes telefonave dhe paisjeve të ngjajshme bëjnë më shumë blerje sesa të vizitojnë dyqanet. 78% shpenzojnë më shumë se 50 dollarë në blerjen e tyre të fundit të veshjeve. Informacioni me qasje të lehtë siguron blerësit me informacionin dhe sigurimin që kanë nevojë për të finalizuar blerjet, duke u dhënë atyre arsye për të bërë investime më të mëdha.
10. Twitter është rrjeti social me ndikimin më të vogël në industrinë e modës. Më përjashtim të veshjeve dhe këpucëve atletike, Twitter nuk ka ndikim në krahasim me platformat më vizuale dhe të detajuara. Twitter është një mënyrë e shkëlqyeshme për të promovuar shitjet online flash dhe promovime të tjera, por është e vështirë të mbash shoqëri në botë pa praninë e fortë të pamjeve (Storms, 2017).

2.3.2 Pse konsumatorët përdorin Mediat Sociale për të blerë?

Elementet të ndryshme në rrjetet sociale ndihmojnë konsumatorët të komunikojnë me njëri-tjetrin më qëllim të përmbushjes së nevojave dhe dëshirave të tyre. Ndërveprimi me njëri-tjetrin i lejon konsumatorët që të kenë ide të qarta për produktet e panjohura (Constantinides, 2004). Përdorimi i rrjeteve sociale në ditët sotme është bërë një nevojë e pashmangshme. Gjatë përdorimit të rrjeteve sociale, konsumatorët preken nga një varg faktorësh si Faktorët e Projektimit, Faktorët e Informacionit, Faktorët e Produktit, Faktorët Psikologjik dhe Faktorët Kulturorë (Constantinides, 2004):

1.Faktorët e Informacionit:

Nëse shumëllojshmëri produktesh dhe informacioni sigurohen mjaftueshëm, atëherë konsumatorët do të jenë të gatshëm që të rrisin edhe më shumë blerjet e tyre në internet. Qfarë i inkurajojnë konsumatorët të blejnë ende më shumë janë ofertat, dhe garancitë që ofrohen së bashku me produktet (Limayem et al., 2000).

2.Faktorët e Projektimit:

Karakteristikat e dizajnit të një faqeje interneti ndikojnë dukshëm tek konsumatorët. Konsumatorët do të jenë më të tërhequr për të blerë në internet nëse faqja e internetit është e dizajnuar mirë dhe përditësohet shpesh. Gjithashtu, përmes ngjyrave, ikonave, lidhjeve, imazheve, dizajnimi tenton të jap informacione të detajuara rreth disa produkteve dhe shfaqjes së temave.

3.Faktorët psikologjik:

Faktorët psikologjik ndikojnë në qëndrimin e konsumatorëve ndaj blerjes online. Konsumatorët do të jenë të gatshëm të blejnë në internet në mënyrë të qetë vetëm nëse ata kanë krijuar besim. Në këtë mënyrë ata reduktojnë pasigurinë drejt një produkti. Për më tepër, konsumatorët mund të ndikohen nga miqtë, familjarët dhe kolegët e tyre që ndikojnë në qëndrimet e tyre.

4.Faktorët kulturorë:

Gjatë procesit të blerjes, konsumatorët mund të preken nga kulturat e tjera në marrjen e vendimeve dhe përzgjedhjen e një produkti të caktuar. Jo me kaq, faktorët kulturore mund të ndikojnë edhe në mënyrën e jetesës së konsumatorëve në përdorimin e teknologjive të reja (Pookulangara dhe Koesler, 2011).

2.3.3 Lloji i mediave sociale të përdorura kryesisht nga konsumatorët

Rrjetet sociale që përdoren më së shumti nga konsumatorët për qëllime të ndryshme janë: Facebook, Twitter dhe Instagram.


Një hulumtim i detajuar nga Miller (2010) tregon se më shumë se 11 milionë konsumatorë përdorin më shumë se 70% rrjetet sociale për të blerë produkte dhe shërbime të ndryshme, për të siguruar informacion të pasur në lidhje me produktin e caktuar dhe për të ndarë komentet me konsumatorët e tjerë (Miller dhe Lammas, 2010). Vetëm në Facebook janë të regjistruar më shumë se 6 milionë konsumatorë për të blerë dhe ndarë informacione rreth produkteve (Scott, 2013). Sipas një studimi të bërë, më shumë se 60% e konsumatorëve të kënaqur rekomandojnë produktet apo shërbimet tek miqët, familjarët apo kolegët e tyre përmes rrjeteve sociale (Parson, 2013). Sipas Kunkel, Facebook ka arritur 51% të përdoruesve të cilët blejnë produkte të ndryshme përmes saj (Kunkel, 2013). Twitter ka regjistruar rreth 800,000 ndjekës të cilët treguan vlerësimin e tyre për shërbimet e ofruara në lidhje me produktet. Ndërsa, përsa i përket Instagram-it, bazuar në aktivitetet e ofruara nga përdoruesit që përdorin Instagram, rezultatet treguan se më shumë se 16 miliardë foto u ndanë mes përdoruesve (Krieger, 2012).

2.4 Modeli klasik/tradicional i blerjes

Procesi i përzgjedhjes së produktit final dikur e një kohe ishte mjaft i komplikuar për shkak të prezencës së variablave të ndryshme të cilat shkaktonin paqartësi tek konsumatorët. Por me kalimin e kohës, Herbert Simon thekson se modeli klasik apo tradicional i marrjes së vendimit për blerje thjeshtësonte modelet e mëdha duke eliminuar variabla të shumta dhe ndërlidhjet e tyre (Simon, 1960). Modeli klasik apo tradicional konsiderohet si një nga modelet më të njohura

dhe më të zakonshme të përdorura në hulumtimin e sjelljes konsumatore (Karimi et al., 2015). Modeli klasik përfshin pesë fazat e vendimmarrjes por Simon thjeshtësoi ende më shumë këtë model duke e zbrërthyer atë vetëm në tri faza si më poshtë:

Figura 2. Procesi i përzgjedhjes së produktit final



Faza e klasifikimit përfshin njohjen e problemit si dhe mbledhjen dhe përpunimin e informacionit. Faza e dytë apo dizajni përfshin gjenerimin dhe vlerësimin e alternativave ndërsa faza e tretë dhe e fundit përfshinë zgjedhjen përfundimtare të një alternative.

2.5Ndikimi i rrjeteve sociale në internet në vendimin e blerjes së konsumatorëve

Informacioni i shpejtë si dhe shuma e pa limitime e materialeve informuese në internet ka bërë që konsumatorët të bëjnë zgjedhjet më të mira të konsumit (Aksoy dhe Cooil, 2006). Gjithashtu interneti ka hapur mundësi të reja për kërkim të informacionit për shkak të kostos së ulët të kërkimit (Jepsen, 2007). Në fakt, interneti ka ndikim të ndryshëm në fazat e procesit të vendimmarrjes të konsumatorit. Në fillim, interneti ishte përdorur vetëm për mbështetjen e fazës së kërkimit të informacionit (Karimi, 2013), por me zhvillimin e trendeve të reja në rrjetet sociale, ndihmat për vendime online dhe sistemet rekomanduese kanë zgjeruar rolin ndikues të internetit në të gjitha fazat e vendimeve. Përveq kësaj kohore si dhe atyre njohëse për blerjen dhe përpunimin e informacionit, konsumatorët kanë fituar besimin dhe njohuri shtese

për produktin me përdorimin e internetit. Tashmë kanale të ndryshme online i japin rëndësi aq të madhe mediave sociale sepse sa më i lartë përdorimi i internetit nga klientët, aq më shumë ka gjasa që ata ta përdorin atë për vendimmarrje (Jepsen, 2007). Sipas disa hulumtimeve të bëra, si përfundim është nxjerr se burimet e ndryshme të informacionit kanë potencial për të ndihmuar konsumatorët të marrin vendime më cilësore (Punj, 2012). Sipas Mangold dhe Faulds, “Konsumatorët përdorin mediat sociale për të mirën e qasjes së menjëhershme në informacion sipas lehtësive të tyre duke i ndihmuar ata që të vendosin se çfarë të blejnë ose të dinë më shumë rreth produkteve apo markave të reja, kur dhe ku duan” (fq.357, 2009). Shembuj të tillë me rezultat po të ngjajshëm janë dhënë edhe nga Xiang dhe Gretzel (2010) dhe Goh et al. (2013). Për më shumë, Yayli dhe Bayram theksojnë se mediat sociale kanë treguar se kanë një ndikim shkakor të konsumatorët në zgjedhjen e produktit dhe sjelljen e blerjes (pp.51–64, 2012). Gjithashtu, Ashman thekson se “mediat sociale kanë sjellë një "kulturë pjesëmarrëse" ku rrjeti i përdoruesve me individë të tjerë me mendime të tilla të angazhohen në një unazë të pandërprerë për ndarjen e informacionit, monitorimin e përditësimeve dhe kërkimin e mendimeve dhe vlerësimeve për të gjitha llojet e produkteve, shërbimeve dhe aktiviteteve” (fq.127, 2015). Më këtë nenkuptohet se çfarë ndikon pozitivisht në qëllimet e blerjes se konsumatorëve është edhe cilësia e rishikimeve të produkteve online të cilat janë të karakterizuara nga informata mjaft të detajuara për produktet.

Në krahasim me komunikimet e korporatave dhe reklamat, mediat sociale perceptohen si burimi më i besueshëm informues. Konsumatorët tashmë janë larguar pothuajse totalisht nga mediat tradicionale si revistat, gazetatat apo televizioni dhe janë drejtuar tek teknologjia e re me e fundit më qëllim për të udhëhequr blerjet e tyre (Mangold dhe Faulds, 2009). Përveq se kompanitë kanë qasje në një shumëllojshmëri të llojeve të teknologjive më qëllim zgjerimin e markave të tyre në tekstil si dhe të përmisojnë marketingun, ato gjithashtu tentojnë që të rrisin interesin e konsumatorit. Kompanitë përmes mediave sociale sfidohen me përcaktimin se si informacioni dhe angazhimi i konsumatorit ndikojnë në aktivitetet biznesore.

2.5.1 Komunikimi me “fjala e gojës”

Fjala e gojës nënkupton zhvillimin e një komunikimi jo komercial ndërmjet njërzëve në lidhje me produktet apo shërbimet. Me specifikisht, është shkëmbimi i informacionit me përvojën e konsumit. Fjala e gojës dallon nga mjetet e tjera të marketingut duke filluar qysh nga strukturimi i saj natyror si dhe nga informacionet rreth shërbimeve apo produkteve (Erkan dhe Evans, 2014). Fjala e gojës posedon dy forma:

1. Forma online
2. Forma offline

2.5.1.1 Forma elektronike

Në etapën e fundit, njerëzit kanë ndryshuar dukshëm mënyrën e komunikimit duke i ndarë mendimet dhe përvojat e tyre personale nëpërmjet internetit. Ky proces quhet “forma elektronike” e fjalës se gojës ose “fjala e gojës online”. Ndryshe ky proces definohet edhe si bashkë-bisedimi i klientëve për një produkt, komunikim ky i cili është vënë në dispozicion të një numri njerëzish dhe institucionesh nëpërmjet internetit. Forma elektronike e fjalës se gojës mund të krijohet edhe nga përdoruesit edhe nga tregu ndërsa informacioni në internet ofrohet nga faqet e krijuara nga shoqëria. Faqet iu mundësojnë njerëzve të ndajnë pikëpamjet e tyre me njëri-tjetërin duke krijuar përmbajtje mediatike si fotografi, video ose tekste. Disa lloje të ndryshme të fjalës se gojës online janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:


Tabela 1. Llojet e ndryshme të fjalës se gojës online

<i>Platforma</i>	<i>Shembuj konkret</i>
<i>Faqet e rrjeteve sociale</i>	Facebook.com, Twitter.com
<i>Faqe te blerjeve online</i>	Amazon.com, Ebay.com
<i>Faqja e rishikimit të konsumatorëve në internet</i>	Epinions.com, Shopping.com
<i>Forume diskutimi në internet</i>	Ukbusinessforums.co.uk
<i>Blogs</i>	Xanga.com, Blogger.com

Burimi: (https://www.researchgate.net/publication/283355913_The_Impacts_of_Electronic_Word_of_Mouth_in_Social_Media_on_Consumers'_Purchase_Intentions)

Studimet e mëparshme kanë theksuar se forma offline e fjalës se gojës të konsiderohet si një mjet i dobët marketingu. Megjithatë, mediat sociale e kanë hequr këtë mangësi duke u ofruar njerëzve mundësinë për të folur me miqtë dhe të njohurit e tyre në internet. Kjo nënkupton transformimin e formës offline në atë online si në figurën e mëposhtme:

Figura 3. Forma online dhe offline e fjalës se gojës



KAPITULLI 3

METODOLOGJIA

3.1 Qëllimi hulumtimit

3.1.1 Plani kërkimor

3.1.1.1 Formulimi i pyësorit

3.1.1.2 Mostra

3.1.1.3 Forma e komunikimit

3.1.2 Mbledhja e të dhënave

3.1.2.1 Metodatat dytësore të grumbullimit të të dhënave

3.1.2.2 Metodatat primare të grumbullimit të të dhënave

3.1.3 Vlefshmëria dhe Besueshmëria e anketimit

3.1.3.1 Metodatat efektive për të rritur pjesmarrjen në anketim

3.1.4 Rrethanat Limituese

3.1 Qëllimi hulumtimit

Fokusimi në zhvillimin global si dhe përdorimi i teknologjisë në fushën e marketingut, reklamimit dhe promovimit kanë fokusuar kompanitë ende më shumë tek konsumatorët. Në etapën e më hershme, ishte mjaft popullore për industrinë e tekstit që të na paraqitej përmes revistave të shkëlqyera dhe shfaqjeve të ndryshme. Nëpërmjet këtyre kanaleve të kontrolluara, moda u mbajt ekskluzive, e përcaktuar nga hartuesit dhe redaktorët e revistës. Por kjo nuk është e mjaftueshme tani. Teknologjia është bërë një element shumë i rëndësishëm në zgjerimin e tregjeve duke përcaktuar strategji të tëra të marketingut. Në të njëjtën kohë, reklamimi dhe promovimi përqendrohen në faktorët kyq të konsumatorit (psikologjik, emocional dhe social) që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit; elemente këto që duhet të përfshihen në marketing të bazuar në teknologji. Si rezultat i kësaj, kompanitë duhet të kenë kujdes ende më të madh gjatë analizës dhe implementimit të 4p (produkti, çmimi, vendi dhe promovimi). Andaj, qëllimi i këtij projekti hulumtues është;

1. Identifikimi i ndikimit të rrjeteve sociale në vendimarrjen e konsumatorit gjatë procesit të blerjes
2. Për të vendosur se sa shpesh konsumatorët hasin në mesazhe të marketingut në rrjetet e ndryshme sociale
3. Të përcaktohet shkalla në të cilën marketingu social ndikon në qëndrimet e konsumatorëve

3.1.1 Plani kërkimor

Projekti përfshinë të dy llojet e të dhënave; të dhënat primare dhe ato sekondare. Fillimisht hulumtimi ka filluar me rishikimin e literaturës dhe marrjes së informacioneve të cilat ishin relevante për këtë studim. Në fakt, literatura e cila është e përfshirë në këtë hulumtim është e gjitha e bazuar në hulumtimet shkencore të bëra më herët më qëllim të zbatimit të projektit në mënyrën më të mirë të organizuar dhe përfaqësuese, duke minimizuar problemet e mundshme. Për këtë arsye, fokusi kryesor ishte trajtimi i çështjes si;

- Definimi specifik dhe i qartë i problemit
- Minimizimi i shqetësimeve hulomtuese
- Çështja e realizimit të mostrës
- Çështjet administrative dhe bias (paragjykimet dhe ndikimet hulomtuese)
- Formulimi i pytësorit

Duke filluar më pikën e parë “definimi specifik dhe i qartë i problemit”, qëllimi kryesor në këtë pjesë ishte vendosshmeria totale nëse problemi apo tema ishte e definuar në rregull dhe qartë. Zakonisht nëse qysh në fillim të projektit titulli është caktuar si temë shumë e zgjeruar, atëherë hulomtuesi gjatë përpilimit total të hulomtimit në pjesën më të madhe të kohës do të ballafaqohet me dyshime dhe pasiguri, sidomos në pjesën e metodologjisë. Për sa i përket “minimizimit të shqetësimeve hulomtuese”, në pjesën më të madhe të përgaditjes së hulomtimit janë bërë pyetje të kohe-pas-kohshme se a është realizuar mostra në rregull, a është prezantuar literatura qartë dhe me informacionet relevante për temën, etj. Tek çështja e realizimit të mostrës, ky seksion prezantonë gatishmërinë e njerëzve për të plotësuar anketat ose për t'u përgjigjur në intervistat. Përveç kësaj, çështjet administrative si koha dhe shpenzimet gjithashtu janë minimizuar në një shkallë mjaft të lartë. Ndërsa fokusi kryesor ishte në çështjet e paragjyimit pasi që ato janë më të vështirat për t'u kapërcyer për shkak të mundësisë që pjesëmarrësit të mos japin përgjigje të pa-vlefshme. Aktualisht, pjesëmarrësit veprojnë kështu për shkak të mungesës së besimit që përgjigjet e tyre do të mbahen private. Së fundi, përpjekja kryesore u vendos në formulimin e pytësorit, më saktësisht në vënien e pyetjeve domethënës dhe të hapura që janë të lehta për tu përgjigjur- jo kërcënuese. Të gjitha pyetjet duhet të thjeshtohen dhe të përfaqësohen në një mënyrë të kuptueshme.

3.1.1.1 Formulimi i pytësorit


Sipas Peterson, R. A. (2000), një pytësor që të jetë maksimalisht i formuluar në rregull, duhet të ndjekë hapat e paraqitur si në vijim;


- Një pyetësor i dizajnuar mirë duhet të jetë në përputhje me objektivat e hulomtimit dhe ti përmbushë ato. Në të kundërtën, pytësori do të lë anash shumë aspekte të

rëndësishme për shkak të punës së papërshtatshme përgatitore duke mos shqyrtuar në mënyrë adekuate çështje të veçanta për shkak të kuptimit të dobët. Ka edhe aspekte negative që deri në një mase janë të pashmangshme. Për këtë arsye, qëllimi i hartimit të mirë të pyetësorit është të "minimizojë" këto probleme.

- Pytësori duhet të përmbaje vetëm informacion të plotë dhe të saktë. Projektuesi i pyetësorit duhet të sigurojë që të anketuarit të kuptojnë plotësisht pyetjet dhe duke mos lenë hapësira për refuzim të përgjigjes. Një pyetësor i mirë është i organizuar dhe formuluar për të inkurajuar të anketuarit që të sigurojnë informacion të saktë, të paanshëm dhe të plotë.
- Një pyetësor i dizajnuar mirë duhet ta bëjë situatën aq të lehtë për të anketuarit që të japin informacionin e nevojshëm (Constructing effective questionnaires).

Për formulimin e pyetësorit të prezantuar në këtë hulumtim janë ndjekur nëntë hapat vijues:





Formulimi i pyetjeve:

Pytësori përmban pyetje të mbyllura, pyetje më dy përgjigje – dihotome, pyetje më shumë përgjigje –multihotome, pyetje me shkallë qëndrimi dhe pyetje të hapura.

Tipi i pyetësorit- i strukturuar

Ndarja e pyetësorit


Pytësori ndahet në dy pjesë: pjesa e parë e pyetësorit përmban të dhëna personale të të anketuareve ndërsa pjesa e dytë përfshinë pyetje gjenerale për ndikimin e rrjeteve sociale

online në vendimarrjen e konsumatorëve gjatë procesit të blerjes në industrinë e tekstilit. Pytësi përfshinë variablat psikologjike të të anketuarëve si qëndrimet, mendimet, vetitë e personaliteti, informimet dhe motivet. Duke u bazur në vetitë e tyre, të anketuarit japin përgjigjet e tyre në pyetjet e parashtruara tek ta.

3.1.1.2 Mostra

Popullsia dhe mostra janë dy terma të rëndësishëm të cilët shpesh herë ngatërrohen. Mostra është grupi i individëve të cilët marrin pjesë në studim. Këta janë individët të cilët marrin pjesë në pytësor. Ndërsa popullata është grupi më i gjerë i njerëzve për të cilët keni ndërmend të përgjithësoni rezultatet e studimit tuaj. Mostra gjithmonë do të jetë një nëngrup i populates.

Figura 2. Mostra



Burimi: <https://www.vectorstock.com/royalty-free-vector/sample-from-population-statistics-research-survey-vector-16452707>

3.1.1.3 Forma e komunikimit

Konsumatorët janë vizituar fizikisht dhe janë pyetur në mënyrë vullnetare për të participuar në anketim. Gjithashtu, pytësi është publikuar në ueb faqe dhe shpërndare tek konsumatorët.

Për regjistrimin e të dhënave janë përdorur edhe programet kompjuterike siq janë excel dhe word.

3.1.2 Mbledhja e të dhënave

Sipas Research-Methodology, “Mbledhja e të dhënave është një proces i mbledhjes së informacionit nga të gjitha burimet përkatëse për të gjetur përgjigje për problemin e hulumtimit, për të testuar hipotezën dhe për të vlerësuar rezultatet” (Data Collection Methods - Research-Methodology). Metodatat e mbledhjes së të dhënave ndahen në:

1. Metodatat dytësore të grumbullimit të të dhënave dhe
2. Metodatat primare të grumbullimit të të dhënave

3.1.2.1 Metodatat dytësore të grumbullimit të të dhënave

Të dhënat sekondare janë të dhënat që tashme e një kohe egzistojnë dhe janë të publikuara në revista, portale, libra, gazeta apo internet, etj. Tek këto të dhëna ekziston një sasi e madhe e informacioneve në lidhje me fushën e kërkimit pa marrë parasysh natyrën e zonës kërkimore. Prandaj, aplikimi i të dhënave sekondare që do të përdoren në studim luan një rol të rëndësishëm në drejtim të rritjes së niveleve të vlefshmërisë dhe besueshmërisë së hulumtimit. Këto kritere përfshijnë:

- Datën e publikimit
- Besueshmërinë e autorit
- Besueshmërinë e burimit
- Cilësinë e diskutimeve
- Thellësinë e analizave
- Shkallën e kontributit të tekstit në zhvillimin e zonës së hulumtimit, etj (Data Collection Methods - Research-Methodology).

Në këtë projekt është bërë një shqyrtim mjaft i detajuar i literaturës e cila përmbush të gjitha kriteret e sapo përmendura më sipër. Përmbajtja e literaturës në këtë punim përfshinë temat

vijuese si: zgjerimi i rrjeteve sociale, media sociale si mjet i ri në marketing, roli i mediave sociale në zhvillimin e markave të tekstilit, cili lloj i konsumatorëve ndikohen më së shumti nga rrjetet sociale dhe pse konsumatorët përdorin mediat sociale për të blerë. Gjithashtu në këtë përmbajtje përfshihen dhe temat tjera vijuese si: lloji i mediave sociale të përdorura kryesisht nga konsumatorët, modeli klasik/tradicional i blerjes, ndikimi i rrjeteve sociale në internet në vendimin e blerjes së konsumatorëve, komunikimi me “fjala e gojës”, etj.

3.1.2.2 Metodatat primare të grumbullimit të të dhënave

Metodat e mbledhjes së të dhënave primare ndahen në dy grupe:

3. Sasiore dhe
4. Cilësore

